



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 3 DHE 4 TETOR 2017

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 03. I 04. OKTOBRA 2017. GODINE

TETOR - OKTOBAR
2017

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Dnevni red

2. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji Finansijskog sporazuma IPA 2016 između Kosova i Evropske unije

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare të mbajtur më 28 shtator 2017.

Në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për punë.

Pika e vetme e rendit të ditës është:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

I kisha lutur deputetët që të qëndrojnë në sallë, sepse duhet të ketë kuorum dhe është tepër e rëndësishme që ta votojmë, besoj që kemi pirë kafe mjaft.

Ju njoftoj që në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 28 shtator 2017, njëzëri është vendosur që Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Andaj, para se të fillojmë shqyrtimin e projektligjit duhet të deklarohe mi për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit. Besoj që grupet parlamentare do të deklarohe n. A doni të deklarohe ni vetëm me votim, apo të flisni të gjithë me radhë.

Nuk e besoj që ka nevojë..., Mirë de, çfarë kam të bëj unë. Atëherë kur do të votosh paraqitu, nuk punon - unë nuk kam faj, unë nuk jam mjeshtër, në fund të seancës po thua nuk punon.

Në rregull, unë mund t'i jap vërejtje teknikës që të merret me kartelën tënde.

Atëherë po votojmë me elektronikë për shmangie nga procedura. Votojmë tani!

Nuk miratohet.

E thërrasim seancën tjetër, nuk po duan të votojnë të dyja palët. Ok! Atëherë të votojmë me dorë, pra. Kush është për, kush është kundër? Nuk duan këta të votojnë. Ju po, por këta nuk po duan. Mirë de mirë, këta janë deklaruar që nuk duan të votojnë. Jeni deklarua që nuk doni të votoi.

(Debat, polemikë)

Jo, nuk e mbylla! Është kërkesë e të gjithë deputetëve, meqenëse teknika nuk ka funksionuar mirë që të votohet me dorë. Ju pres në qoftë se kthehen deputetët tuaj, uluni votoni, nuk kam ndonjë problem fare. Është me interes për qytetarët, s'është për interes as partiak, as.. Konsultohuni, edhe ashtu ju presim. Sa po doni të ju presim? Mirë është të ktheheni.

Atëherë, unë propozoj një pauzë prej 10 minutash, dhe po e provojmë mos Grupi Parlamentar i LDK-së po vendos të kthehet në sallë. Nuk di çka të bëj më shumë, që të mos qëndrojmë këtu ulur. Pimë kafe, a bisedojmë.

(Pauzë e shkurtër)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

KRYESUESI: Atëherë, për arsye objektive, unë e shtyj vazhdimin e mbledhjes për nesër, në orën 10:00, besoj që do të bisedojmë me Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe besoj që do të vijmë nesër.

* * *

E mërkurë, më 4 tetor

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 3 tetor 2017

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Ju kisha lutë që t'i zini vendet tuaja, ta konstatojmë kuorumin dhe të fillojmë me punë.

Para se të hyjmë në procedurë, zoti Liburn Aliu ka kërkuar që ta bëjë një deklaratë lidhur me votimin e djeshëm dhe unë i jap të drejtë që ta bëjë deklaratën në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Në lidhje me votimin e djeshëm, unë po mendoj se ka parregullsi, meqenëse në mesin e deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” janë gjashtë këtu, të cilët kanë qenë dje të pranishëm, nuk u ka funksionuar teknika. Ju po ashtu keni deklaruar që do t'i numëroni edhe votat me dorë, është ngritur vota, por në këtë dokumentin që na ka ardhur po del që të gjithë nuk kemi qenë të pranishëm në sallë.

Konsideroj që votimi duhet të përsëritet, sepse dje po ashtu as nuk janë ftuar deputetët për votim dhe nuk ka rënë zilja siç ndodh zakonisht.

Mendoj se kemi mjaft bazë për ta konsideruar atë si votim të parregullt dhe kërkojmë që ai votim i djeshëm të përsëritet në lidhje me interpelancën që e patëm dje.

KRYESUESI: Faleminderit! Votimi ka përfunduar, rezultati është 40:26 me elektronikë, një pa elektronikë, që është paraqitur zonja Dërguti, një abstenim dhe kemi pasur verifikime pikërisht nga këndvështrimi që po e thoni ju, që është votuar dhe është deklaruar që nuk ka punuar teknika. Ne s'mund ta përsëritim votimin, mund të bëni ankesë si grup parlamentar pastaj nëpër komisione, por pasi të përfundojnë zakonisht më nuk mund të votohet. Edhe nëse kanë qenë këta gjashtë deputetë, sikur të ishte numëruar vota, po ju them që janë 40 vota kundër, 27 për, një abstenim. Edhe sikur të ishin gjashtë, vota do të bëheshin 33:40, kështu që rezultati është i njëjtë, është refuzues. Ndoshta dikujt i ka mbetur puna, i ka dalë vota gabimisht, është problem juaji, e tjetër herë po shpresoj që do ta zgjedhim pak më mirë. Nuk ka diskutim më. Futemi në seancë.

Të nderuar deputetë,

Për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren në Kuvend.

Ju e dini që për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me dy të tretat e deputetëve të pranishëm në seancën plenare, neni 84 i Rregullores së Kuvendit.

Për t'iu shmangur nga kjo Rregullore, kërkoj që ne ta konstatojmë së pari kuorumin. Janë gjithsej 94 deputetë të pranishëm.

A doni të votoni me ngritje dore apo me elektronikë? Unë kam informata që elektronika po punon. Po e provojmë me elektronikë më lehtë, që të mos marrim kohë. Nëse nuk funksionon, atëherë votojmë me dorë.

Atëherë, lus regjinë dhe juve zonja dhe zotërinj, që të përgatiteni për votim. Votojmë tani!

Këtu elektronika po bën, është funksionale.

Atëherë, në sallë janë 96 deputetë, por megjithatë ne si Kuvend e kemi miratuar, me elektronikë kanë votuar 83 deputetë dhe 83 janë për.

A ka pa elektronikë, 9 vota janë plus pa kartelë, që do të thotë 92 vota për.

Pra, konstatoj që me 92 vota për, Kuvendi e miratoi shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Projektligjin...

Dua të them që asnjë votë nuk është kundër, asnjë votë nuk është abstenim, të gjithë deputetët me unanimitet e kanë votuar shmangien nga Rregullorja.

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij së bashku me amendamentin e propozuar.

Tani ftoj diskutuesit sipas përgjegjësisë që e kanë. Në fillim, e ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, përkatësisht ministren për Integritet, zonjën Hoxha, që ta marrë fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja financiare për IPA 2016, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, është nënshkruar në prill të këtij viti.

Për të siguruar hyrjen e saj në fuqi në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për marrëveshje ndërkombëtare kam kënaqësinë ta prezantoj para jush Projektligjin për ratifikim të IPA 2016.

Kjo marrëveshje financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2016, pjesa e parë, që përfshin gjashtë projekte, të cilat do të ndihmojnë përafrimin me Legjislacionin e Bashkimit Evropian, të drejtat e komuniteteve, rritjen e konkurrueshmërisë për ndërmarrjet kosovare, si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikat sociale.

Në tërësi, programi konsiston në financimin e 45,5 milionë euro nga Bashkimi Evropian për Kosovën, ndërsa shuma totale e përfshirë është 71,15 milionë euro, në të cilat përfshihet edhe ofrimi i kredive nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në vlerë prej 20,5 milionë për operatorët privatë, si dhe një shumë bashkëfinancimi nga Kosova në vlerë prej 4,75 milionë, nga të cilat 2,75 milionë janë nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, një milion nga Ministria e Integritimit dhe një milion nga Ministria e Arsimit.

Përfituesit individualë të granteve do ta bashkëfinancojnë vlerën totale të marrëveshjes financiare në shumë prej 400 mijë euro.

Me këtë rast, ju ftoj ta miratoni Projektligjin në fjalë dhe menjëherë pas kësaj do ta finalizojmë gjithë procedurën që sa më parë të bëhet hyrja në fuqi, ashtu që fondet e parapara me këtë marrëveshje të fillojnë zbatimin për projekte për të cilat janë planifikuar.

Gjithashtu, dua të ju rikujtoj dhe të ju njoftoj se afati përfundimtar për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje financiare është 31 dhjetori i këtij viti.

Prandaj, më lejoni të shpreh vlerësimin tim më të lartë për gatishmërinë e treguar nga Legjislativi për ta përfunduar sa më parë ratifikimin e IPA 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hoxhaj! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Integritime Evropiane, zonjën Blerta Deliu-Kodra, për arsyetimin e raportit të Komisionit.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, ministra,

Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka për qëllim miratimin e programit vjetor IPA 2016 nëpërmjet së cilës zbatohet asistencë financiare e realizuar nga Bashkimi Evropian për Kosovën në kuadër të asistencës nëpërmjet instrumentit financiar të IPA-s.

Kjo asistencë financiare bëhet kryesisht nëpërmjet projekteve, të cilat edhe janë përshkruar në këtë marrëveshje, e cila i ndihmon institucionet e Republikës së Kosovës në përgjithësi dhe në veçanti Qeverinë dhe institucionet tjera të pavarura për realizimin e prioriteteve nacionale dhe sektoriale nëpërmjet shfrytëzimit të këtyre burimeve financiare, e që kryesisht kanë për qëllim realizimin e objektivave, të cilat kanë dalë nga MSA-ja.

Marrëveshja është realizuar në kuadër të procesit të integritit evropian dhe shfrytëzimit të ndihmës financiare në kuadër të instrumentit të asistencës para anëtarësimit, siç është IPA 2. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje të të dyja palëve, në këtë rast Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian obligohen të japin kontribute të përbashkëta financiare ashtu siç parashihen edhe në këtë marrëveshje. Ndërsa, në kuadër të këtij programi veprimi për Kosovën, për vitin 2016 janë përzgjedhur kryesisht këta sektorë: Demokracia dhe qeverisja, Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore, Konkurrueshmëria dhe inovacioni, si dhe Arsimi, punësimi dhe politikat sociale.

Secili nga këta sektorë është ndërtuar duke u bazuar kryesisht në asistencën e ofruar në të kaluarën nga Bashkimi Evropian nëpërmjet IPA1, IPA2 në vitin 2014, dhe në vitin 2015. Kjo marrëveshje, ashtu siç u tha edhe na ministrija Hoxha, e ndihmon Republikën e Kosovës në përmbushjen e kritereve për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe zbatimin e obligimeve, të cilat dalin nga MSA-ja.

Komisioni për Integritime Evropiane gjatë ditës së djeshme e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe siç tha edhe zoti Haliti, është votuar unanimisht nga të gjithë anëtarët komisionit. Do të thotë, Komisioni për Integritime, në mbledhjen e mbajtur më 3 tetor, e shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, marrëveshjeje e cila definon asistencën e dhënë nga BE-ja për Kosovën në kuadër të IPA-s. Komisioni vlerësoi se asistencën e BE-së në kuadër të IPA-s, në formë të projekteve të përshkruara në këtë marrëveshje paraqet një kontribut të veçantë për ta fuqizuar kështu procesin e integritit evropian në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Besoj që edhe kolegët do të kyçen gjatë diskutimit të sotëm dhe ju ftoj ta votoni këtë marrëveshje, e cila mori mbështetjen e Komisionit për Integritime Evropiane.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare, ose me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” është paraqitur zoti Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,
Mysafirë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojë për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016, por është për keqardhje qysh kryeministri, me zellin që e pati dje të ishte në seancë gjatë gjithë kohës, sot për një marrëveshje kaq të rëndësishme nuk është i pranishëm. Është gjithashtu për të të ardhur keq që duhet ta amandamentojmë ende sa u përket dokumenteve që dalin prej Kuvendit. Pra, duhet të bëjmë amandamente që të vendoset fjala “republikë” në dokumentet e Kuvendit.

Sido që të jetë, gjithashtu besoj që kjo marrëveshje mund të ndihmojë jo vetëm në temat të cilat janë paraqitur këtu, qoftë nga përfaqësuesja e komisionit, por edhe nga ministrja, por gjithashtu edhe për komunat dhe rrjedhimisht më duhet të theksoj që komunat janë ato, të cilat duhet të jenë thithëset më të mëdha të këtyre fondeve, e rrjedhimisht edhe në këtë rast këtu e përmend edhe Pallatin e Rinisë. Është tepër e rëndësishme që Republika apo Qeveria t’ia bartë Komunës kompetencat e Pallatit të Rinisë, në mënyrë që Komuna e Prishtinës me fondet IPA të bëjë renovimin dhe restaurimin e plotë të kësaj qendre kulturore dhe sportive në Prishtinë.

Po e theksoj edhe një herë, Lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë për, por gjithsesi është për keqardhje që këtu nuk e kemi kryeministrin, i cili zotohet aq shumë për njëfarë të themi qeverisje me standarde dhe në përputhje me vlerat evropiane. Në fakt, për njërin prej marrëveshjeve më të rëndësishme financiare nuk gjen kohë që të jetë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sejdiu! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesues i seancës, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më vjen shumë mirë që Kuvendi përfundimisht po e shqyrton këtë marrëveshje, Marrëveshjen IPA 2016, e cila për njoftimin e deputetëve dhe të qytetarëve është marrëveshje që është negociuar nga Qeveria Mustafa. Prioritetet që janë përcaktuar në këtë marrëveshje janë negociuar në detaje nga ministrat e ish-Qeverisë. Në marrëveshje tekstualisht shkruan se fondet ndahen në përputhje me prioritetet e Qeverisë së Kosovës, bazuar në Strategjinë Zhvillimore 2015-2018, të cilën e kemi punuar gjatë mandatit të kaluar.

Kjo marrëveshje është e rëndësishme nacionale. Ne sigurisht që nuk mund të lejojmë që kjo marrëveshje të mos ratifikohet. Atë që e kemi bërë dje, me sjelljen tonë si Lidhje Demokratike, është që t’i tregojmë Qeverisë se marrëveshjet e rëndësishme të tillë nuk mund të kalojnë pa votat e opozitës shqiptare, nuk mjaftojnë votat e Listës serbe. Ne do të votojmë për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje pa asnjë dyshim, të gjithë deputetët tanë, sepse jemi i vetmi partner kredibil i Bashkësisë Evropiane në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016, njëkohësisht e konsiderojmë si moment të mirë që ka një vullnet politik të të gjitha subjekteve për ta mbështetur këtë marrëveshje dhe marrëveshje të tilla që janë të rëndësishme për vendin. Siç e dimë, BE-ja nëpërmjet këtij instrumenti e mbështet vendin tonë dhe prioritetet e Qeverisë në fusha të ndryshme.

Është mirë që kjo asistencë konsiston jo vetëm në mbështetjen financiare, por edhe në procesin e disenjimit të prioriteteve. E shfrytëzoj rastin që t'i ftoj Ekzekutivin tonë, Qeverinë dhe institucionet tjera që të jenë të vëmendshëm në implementimin e këtyre projekteve. Siç e dimë, kjo mbështetje kaq e rëndësishme shpeshherë ka pasur vonesa në terren. Shpresojmë që të gjitha këto projekte, e gjithë kjo mbështetje të vazhdojë dhe të na gjejë kështu së bashku, jo vetëm në aprovimin, por edhe në mbështetjen dhe implementimin e këtyre projekteve. Faleminderit! Pra, PDK e mbështet këtë marrëveshje dhe këtë ratifikim.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, zoti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I mi smo svesni koliko je ratifikacija ovog sporazuma važna za naše sugrađane, i zbog toga čemo podržati ovaj nacrt zakona koji omogućava ratifikaciju ovog međunarodnog sporazuma. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas shqyrtimit në Komisionin për Integritet Evropian, projektligji në fjalë është aprovuar dhe po ashtu është shqyrtuar edhe në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe do ta votojmë, sepse ka rëndësi të veçantë, sidomos kur kemi parasysh marrëdhëniet me Bashkimin Evropian dhe fondin, i cili i ofrohet Kosovës në segmente të caktuara të nevojshme.

Po ashtu, mund të ju them se nuk është mirë që të keqpërdoret vazhdimisht fjala, sepse kryeministri nuk ka kohë për çdo projektligj, për çdo vendim, për çdo ngjarje kur është ministrja e Integritetive këtu, e cila e prezantoi projektligjin. Po ashtu, ne kemi qenë në opozitë në të kaluarën dhe çdo marrëveshje ndërkombëtare, e cila ka pasur të bëjë me interesa vitale të Kosovës e kemi përkrahur, prandaj kapriciet duhet të ndalen dhe të veprohet si opozitë, e cila e konsideron të nevojshme që për çështje kapitale të votojë për.

KRYESUESI: Unë mendoj që vërejtjet janë me vend të atyre që kërkojnë për të qenë ministrat dhe kryeministri në sallë, por ne e kemi një njoftim zyrtar që kryeministri është në një takim zyrtar me Qeverinë me një delegacion të huaj. Unë nuk desha, se edhe zonja Dhurata na njoftoi, sidoqoftë tani nuk ka nevojë që të shtyhem me grupe rreth kësaj çështjeje, por kërkesa për të qenë të pranishëm dhe domosdoshmëria për të qenë në seanca është permanente për të gjithë ministrat. Ministrat që s'vijnë në sallë gjatë seancave dhe kur ka çështje, atëherë edhe seancat nuk e kanë ndonjë nivel do ta thosha të pranueshëm.

Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, fjalën e ka zoti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e mbështet Marrëveshjen financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Po ashtu kërkojmë nga Qeveria që kjo marrëveshje të implementohet në kohë dhe të zbatohet në përpikëri sipas prioriteteve të përcaktuara, dhe ne e mbështetim plotësisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zonja Duda Balje.

DUDA BALJE: Hvala!

Parlamentarna grupa “6+” je razmatrala ratifikaciju finansijskog sporazuma i naravno da ćemo ga podržati, u nadi da će finansijska sredstva koja su ovog puta dodeljena za manjine biti proporcionalno podeljena za sve manjinske zajednice, koje se nalaze na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Është paraqitur zoti Pacolli pa grup parlamentar që t'i japë mbështetje...

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje për ju dhe për të gjithë kolegët këtu!

Grupi i AKR-së e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe sigurisht se e mbështet fuqishëm, por kemi kërkesë që kjo të analizohet mirë dhe të shpërndahet në një formë proporcionale, por mos harroni se për sot ka më së shumti nevojë Prishtina, se Prishtina është kryeqyteti i Kosovës dhe ka projekte të mëdha, të cilat e meritojnë ta kenë një sy më të theksuar se të tjerat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Avdullah Hoti, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Vetëm për qartësim, dy gjëra: Nuk ka asgjë më të rëndësishme sot, asnjë ngjarje s'mund të jetë më e rëndësishme për kryeministrin sesa të jetë në seancë, ku ratifikohet marrëveshja që nënkupton mbështetje financiare për Kosovën prej 71 milionë euro, e para.

Dhe e dyta, për rikujtim të zotit Isufi, partia e tij nuk e ka votuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit kur është ratifikuar këtu në Kuvend, që është marrëveshja më e rëndësishme pas shpalljes së Pavarësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Shkurtimisht do t'i them disa fjalë, sepse besoj se është shumë e rëndësishme që ta miratojmë sa më parë. Nga ajo që e thatë edhe ju, kryeministri bashkë me një pjesë të ministrave janë në takim pikërisht me delegacionin e Bashkimit Evropian, që ndërlidhet me këtë ratifikim të marrëveshjes që po e bëjmë.

Siç u deklarua edhe përfaqësuesi në emër të grupit tonë, ne e mbështetim plotësisht Marrëveshjen IPA-2016, sepse konsiderojmë që është një ndihmesë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës fondi prej 45,5 milionë euro, që ndahet nga Bashkimi Evropian, dhe totali prej 71,15 milionë euro është bashkë me pjesën e menaxhimit indirekt dhe bashkëfinancimit të Qeverisë. Por, unë dua ta them këtu ndoshta një vërejtje, ose një mesazh që do të kisha shumë dëshirë që ta marrin seriozisht edhe Ministria e Integritimit Evropian, e veçanërisht zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Kur është miratuar IPA 2 për vitet 2014-2020 kanë qenë tri fusha prioritare, të cilat pastaj kanë reflektuar edhe në ndarjet buxhetore përgjatë gjithë viteve individuale dhe një nga këto fusha ka qenë edhe Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Unë, personalisht, duke qenë ministër i Bujqësisë në mandatin e kaluar, këtë shqetësim për IPA-2016 ua kam shprehur edhe zyrtarëve të BE-së dhe të Ministrisë së Integritimit. Këtë shqetësim e shpreh edhe sot si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkoj që në të ardhmen në asnjë mënyrë të mos bëhet shmangie nga prioritetet, pavarësisht që të gjithë sektorët e përfshirë në IPA 2016 janë të rëndësishëm. Por, i ftoj zyrtarët e BE-së dhe zyrtarët e Ministrisë së Integritimit Evropian që për IPA 2017 dhe tutje të jenë pak më të kujdesshëm dhe të mos marrin vendime në kundërshtim me prioritetet, të cilat i kemi miratuar bashkërisht në fillim, sepse prapëseprapë do të duhet të vijnë në Kuvend dhe prapë do të duhet t'i kenë 2/3-at e votave. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Teuta Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Normalisht se jemi para një akti që është me rëndësi për gjithë Republikën e Kosovës, pra ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, por mbi të gjitha normalisht që është interes për secilën prej komunave të Republikës së Kosovës, në veçanti për kryeqytetin.

Pas hapit shumë të rëndësishëm që kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, ka marrë edhe për Ligjin për Prishtinën, që për herë të parë pra është bërë një hap, që është me interes për vetë kryeqytetin, prandaj unë uroj që sa më parë të vijë në komisione dhe të ratifikohet ligji i shumëpritur. Pastaj, normalisht se përfitojnë të gjitha komunat, por në veçanti pas këtij hapi shumë të rëndësishëm, që nuk e patën guximin asnjë për të ecur tutje, e bëri ai që çdo ditë po i bën veprimet e duhura.

KRYESUESI: Unë ju kisha lutur që të ndërpritet fushata. Nuk kemi fushatë. Ta hedhim në votim këtë dhe të shkojmë, sepse të gjithë kemi çfarë të flasim. Çdo komunë i ka nevojat e saj, janë përgjegjësit që i ndajnë këto fonde bashkë me Zyrën e Bashkimit Evropian dhe në qoftë se jeni dakord, unë do ta hedhja në votim menjëherë. Se diskutimet s'mund t'i ndaloj, por sidoqoftë të mos e shndërrojmë në fushatë, se ne s'mund ta ndajmë këtë buxhet si Parlament.

Në rregull! Korab, a deshe të flasësh? Milaim Zeka është në radhë.

MILAIM ZEKA: Zoti kryesues!

Unë do të rri në temë për çfarë jemi duke diskutuar dhe nuk do të bëj fushatë, sepse çdonjëri vërtet po e shfrytëzon foltoren për fushatë elektorale.

Desha një sqarim para publikut: Ne dje e kemi pasur një takim si Komision për Integritet Evropian, kemi pasur takim me ministren e nderuar aty, dhe të gjithë unanimisht, edhe përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe përfaqësuesit e Lëvizjes "Vetëvendosje", edhe ne kemi qenë, jemi bashkuar rreth vërejtjes që i kemi dhënë ministres sonë, që në dokumentet e ardhshme të mos na vijmë pa shkrimin "Republika e Kosovës", për çka është pajtuar edhe ministrja jonë. Kjo të mos shfrytëzohet si meritë e dikujt, por meritë e të gjitha partive dhe përfaqësuesve të partive në Komisionin për Integritet Evropian, e para.

E dyta, sa i përket shpërndarjes së këtyre mjeteve, do të flasim pas datës 22, pas fushatës, sepse po të më pyesë dikush mua - krejt këto para do t'i kisha çuar në Obri e në Likoc, por nuk jemi këtu për fushatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Fitore Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,

Unë po ndalem te sektori i arsimit, pra fondet IPA, të cilat do të investohen sa i përket sektorit të arsimit, e sidomos në rritjen e numrit të fëmijëve, të cilët do të kenë mundësi ta ndjekin mësimin parashkollor, pra edhe kjo të bëhet nëpërmjet ndërtimit të çerdheve të reja. Unë kisha kërkuar nga Ministria e Arsimit që të jetë në koordinim me këtë marrëveshje, në mënyrë që kur të ndërtojmë çerdhe të reja, në secilën komunë të Kosovës të llogaritet edhe numri i stafit administrativ dhe edukativ që duhet të punësohet në këto çerdhe.

Po e them këtë për shkak se Komuna e Prishtinës tashmë ka hapur 5 çerdhe, 2 tjera janë në proces të hapjes dhe ka në plan të hapë edhe 4 çerdhe tjera, për të cilat është dashur të mendojë mënyrë të funksionimit të këtyre çerdheve, për shkak se Ministria ka refuzuar gjithmonë që ta mbështesë Komunën e Prishtinës, duke i dhënë mundësi që të punësojë stafin e nevojshëm që i nevojitet secilës çerdhe.

Ne e kemi aplikuar modelin “Çerdhe me bazë në komunitet”, duke u mundësuar që punësimi i stafit të bëhet direkt nga Këshilli i Prindërve dhe pagesa e tyre të bëhet nëpërmjet buxhetit të çerdes, e jo përmes buxhetit të Komunës. Pra, këtë e kanë pamundësuar Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave, duke ia bllokuar Komunës së Prishtinës punësimin e stafit të nevojshëm për këto çerdhe. Nuk do të ishte mirë që kjo të përsëritet edhe për komunat tjera, që në vend se të hapin çerdhe publike, që është mënyrë shumë më e lehtë dhe më e shpejtë, të shkojnë në një proces më të gjatë, duke krijuar modele të reja të çerdheve, për të siguruar që fëmijët në të gjitha komunat ta ndjekin mësimin parashkollor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua të ju them që unë nuk kam hapur debat se si do të shpërndahen mjetet. Ne do të futemi në votim, se këtu tash kanë dalë me lloj-lloj propozimesh. Nëse doni debat për këtë çështje, ushtroni mocion - e votojmë mocionin. Ne nuk kemi debat se si do të shpenzohen mjetet. Ne e kemi një ligj përpara, të cilin duhet ta votojmë, ose s’do ta votojmë. Na duhen 80 vota për ta kaluar. Nëse doni debat, pasi të miratohet ligji, hajde bëni mocion kushdo dhe e hedhim në votim edhe mocionin për debat. E tash, në qoftë se flet dikush, nuk mund t’ua ndalë të tjerëve. Unë po dua ta shkurtoj procedurën, sepse dikush po nervozohet, dikush... Sipas procedurës, nuk është debati se ku do të shpenzohen paratë. Këtu është problemi.

Unë e hedh në votim... Zonja Haxhiu e ka fjalën lidhur me një çështje që ka të bëjë me ligjin dhe ka të drejtë për çështjen që po flet.

ALBULENA HAXHIU: Veç po dua të them, zoti kryesues i seancës, që nuk keni të drejtë ta ndalni fjalën e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Çfarëdo që ata flasin janë deputetë dhe përfaqësojnë interesat e qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Unë jam për ta dhënë dhe për ta ndalë fjalën... Për atë punë jam këtu.

Vërejtja ime në Projektligj për ratifikimin e Marrëveshjes financiare të IPA-s ka të bëjë saktësisht me nenin 2. Po e lexoj, ata që janë juristë ndoshta e kuptojnë më mirë, të tjerëve po mundohem t’ua shpjegoj edhe unë.

Ratifikimi i marrëveshjes: Marrëveshja financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Marrëveshja dhe shtojcat e saj janë pjesë integrale e këtij ligji. Kjo qysh është shkruar e përmbys rendin e gjërave,

për shkak se ratifikimi ndodh me 2/3-at e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, kështu e thotë Kushtetuta, pastaj ligji hyn në fuqi në bazë të procedurave siç e përcakton edhe Kushtetuta, edhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës.

Dhe, në momentin kur shpallet në Gazetën Zyrtare pastaj konsiderohet që hyn në fuqi. Pra, unë nuk e di se kush e ka shkruar këtë, ndoshta Ministria e Integritimit Evropian dhe çuditërisht si zonja Hoxha e bën një lëshim të tillë, sepse kjo është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës. Andaj, unë kërkoj, e di se nuk lejohet që në seancat plenare të bëhen amendamente, mirëpo ky nën duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës, e jo të lejohet që të votojmë amendamente apo nene të tilla që janë në kundërshtim me Kushtetutën. Ne tashmë kemi precedente, shumë herë kemi bërë amendamente në seancë plenare, andaj është shumë më mirë që kjo të përmirësohet, pastaj të votohet nga deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Unë mendoj që vërejtjet që kanë të bëjnë me ligjet gjithmonë duhet të jenë pjesë e debatit, por jo vërejtjet ose çështjet që kanë të bëjnë me fushatën aktualisht. Në qoftë se është në kundërshtim me Kushtetutën, unë besoj që Komisioni i Ligjeve do ta ketë parasysh këtë, edhe Ministria dhe në kundërshtim me Kushtetutën nuk miratohet asgjë dhe nuk konsiderohet çështje ligjore.

Unë e ftoj regjinë që t'i bjerë ziles dhe të përgatitemi për votim...

(Ndërprerje e incizimit)

Proceduralisht mendoj se Administrata duhet t'ia përcjellë, jo veç komisionit, por të gjitha komisioneve. Atëherë, ne e kemi një amendament të propozuar nga Komisioni Funkcional për Integritimit Evropian në këtë ligj dhe e hedhim në votim.

Së pari, amendamentin e Komisionit për Integritimit Evropian, pastaj propozimin e kryetares së Komisionit për Legjislacion ia shtojmë pjesën që po thotë zonja Haxhiu. Unë mendoj që nëse është çështje kushtetuese dhe nëse vlerësojmë kështu, nuk ka nevojë për t'i ndjekur procedurat edhe tri javë të endemi nëpër zyra, por e miratojmë tani.

E miratojmë amendamentin e propozuar nga Komisioni Funkcional për Integritimit Evropian. Votojmë tash!

Kanë votuar 97 deputetë, 90 janë për, 7 kundër, 1 abstenim. A ka dikush me dorë? Fisniku. 2 vota janë për. Do të thotë, janë 92 (90 me kartelë, 2 pa kartelë, 3 pa kartelë), do të thotë janë 93 vota për, 7 kundër 1 abstenim.

Zonja Haxhiu a po e përsëritni propozimin tuaj edhe një herë, konkretisht, pa arsyetime, që ta votojmë, ta kalojmë me votim.

ALBULENA HAXHIU: Rendi do të ishte që të marrim të paktën 10 minuta pauzë, në mënyrë që Komisioni për Legjislacion të mbledhet, sepse unë nuk mund në emër të Komisionit për Legjislacion për sa kohë që s'e kam mbledhur Komisionin për Legjislacion.

KRYESUESI: Kur ta miratojë seanca, kryhet ajo punë. Propozoje ti, mos...

ALBULENA HAXHIU: Marrëveshja financiare për IPA-n 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian konsiderohet e ratifikuar me 2/3-at e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe hyn në fuqi në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! E hedh në votim propozimin e kryetares së Komisionit për Legjislacion. Atë që e ka propozuar për ta miratuar, mendoj që është mirë. Votojmë tani!

Kanë votuar 99 deputetë me kartelë, 2 pa kartelë. Janë 101 deputetë në sallë që kanë votuar dhe 101 vota janë për. Amendamenti më i votuar në historinë e Parlamentit besoj që është.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, së bashku me amendamentin e miratuar.

Në sallë janë përsëri 102 deputetë. Votojmë tani!

Kanë votuar 96 deputetë, 96 janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Pa kartelë janë Fisniku dhe Kinolli, bëjnë 98 deputetë, 98 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*